



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 225, datë 09.11.2021

MBI

FILIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “IRARBA ENERGI” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UNITED BANK OF ALBANIA) SH.A.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të Licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 4, gërma “b”, nenit 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 139/2 prot., datë 28.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “IRARBA ENERGI” sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (United Bank of Albania) sh.a.”,

Konstatohet se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1012 prot., datë 18.10.2021, shoqëria “IRARBA ENERGI” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosje hipoteke dhe barrë sigurorese/peng të aseteve në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (United Bank of Albania sh.a.).
- Shoqëria “IRARBA ENERGI” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.09.2019, i ndryshuar dhe është mbajtëse e licencës nr. 451, seria P19.
- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “IRARBA ENERGI” sh.p.k. në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi ka mungësi sa më poshtë vijon:

Neni 7, Përbërja e kërkesës për transferim

Pika 1. Një përshkrim i të licensuarit që përmban informacion mbi:

- **gërma “c”** (Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve). **Plotësuar pjesërisht**

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për 2 vitet e fundit, 2019 dhe 2020.

- **gërma “d”** (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare) **Plotësuar pjesërisht.**

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të bankës apo një përmbledhje të performancës/pozicionit financiar në treg të saj për 2 vitet e fundit, 2019 dhe 2020.

- **gërma “h”** (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen) **Plotësuar pjesërisht.**

Shoqëria duhet të depozitojë marrëveshjen paraprake të nënshkruar midis palëve, së bashku me listën e asetëve, si pjesë integrale e marrëveshjes.

- **gërma “i”** (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit). **Plotësuar pjesërisht.**

Shoqëria duhet të depozitojë deklaratën e bankës sipas formës së kërkuar (originale ose fotokopje e noterizuar).

- **Pika 3** (Subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoriteti shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve). **Pa plotësuar**

Referuar nenit 17.3 të kontratës së koncesionit të formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentralit “Shengjun”, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informimin e Autoritetit Kontraktor në lidhje me transferimin e asetëve dhe, sipas rastit, miratimin përkatës të AK-së, nëse shoqëria ngarkohet me një detyrim të tillë.

- **Pika 6** (Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mosbërjes publike të tyre) **Pa plotësuar.**

Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse dëshiron që pjesë të dokumentacionit të aplikimit të mos jenë të hapura për publikim, së bashku me arsyet përkatëse.

- Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë, rezulton se më datë 09.09.2021, është publikuar çështja CN-782802-09-21, për vendosjen e një mase sigurimi tatimor mbi pasurinë dhe të drejtat pasurore të shoqërisë. Sa më sipër shoqëria duhet të informojë ERE-n mbi fazën në të cilën ndodhet ky proces (nëse është apeluar, apo është në ndonjë proces gjyqësor), si dhe deri ku shtrihet kjo masë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (United Banka of Albania sh.a).
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.